



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 11 paragrafi Rregullores Nr. 03/2023 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 07.02.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Mbyllet rasti Nr.APK-DPKI-06-1422/24, për zyrtaren e lartë znj. Artina Hamitaga, Këshilltare e Jashtme e Ministrit të Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, për shkak të është shmangur gjendja e papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik.

A r s y e t i m

Rasti i hapur (sipas informatës së pranuar) nën dyshimin për papajtueshmëri dhe situatë të mundshme të konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtaren e lartë znj. Artina Hamitaga, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në tekstin e më tutjeshëm: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi ishte raportuar se znj. Artina Hamitaga, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtare e lartë publike, respektivisht Këshilltare e Jashtme Ministrit të Mbrojtjes, e njëjta në të njëjtën kohë është aksionare dhe person i autorizuar në dy biznese private.

Sipas procedurës, në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka dërguar shkresën zyrtare DPKI-06-1422/24, duke e njoftuar zyrtaren e lartë për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së papajtueshmërisë në ushtrimi e funksionit publik. Pas kësaj, është organizuar dhe mbajtura një takim në zyrat e Agjencisë, me ç' rast zyrtarja në fjalë është njoftuar me pretendimet e ngritura për situatën e mundshme të konfliktit të interesit, respektivisht papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik. Në këtë takim zyrtares në fjalë i është bërë me dije se gjatë ushtrimit të funksionit publik në cilësinë e zyrtares së lartë publike, nuk mund që njëkohësisht të mbajë funksion drejtues e as të jetë përfaqësuese i autorizuar apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare, si dhe nuk mundet të ushtrojë në mënyrë aktive të drejtën e administrimit dhe drejtimit në një ndërmarrje, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj.

Në këtë rast mbajtja e funksionit si person i autorizuar në bizneset private paraqet gjendje të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik, siç përcaktohet me nenin 13, paragrafi 1, dhe 15, paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku thuhet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”, si dhe “Zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë në mënyrë aktive të drejtën e administrimit dhe drejtimit në një ndërmarrje, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj.

Pas sqarimit dhe diskutimit të fakteve, zyrtarja e lartë është pajtuar me gjetjet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, duke deklaruar se: *Sa i përket kufizimit apo papajtueshmërive eventuale që lidhen me personin e autorizuar në biznesin privat nuk ka pasur njohuri por është zotuar se në afatin sa me të shpejt do të ndërmarr veprime të menjëhershme dhe konkrete në mënyrë që të shmangë papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik, duke hequr dorë nga përfaqësuesi i autorizuar (në biznes), njëhë rit ka deklaruar se nuk ka asnjë kontratë apo çfarëdo raporti tjetër të punës me institucionin ku është e angazhuar si këshilltare pran Ministrisë së Mbrotjtës, ndërsa sa i përket angazhimit apo funksionit në biznes privat tek biznesi me emër “Ulpiana Consulting L.L.C” ka deklaruar se aji ka mbet vetëm i regjistruar dhe nuk ushtron veprimtari dhe është pasiv.*

Ndërkohë Agjencia bazuar në mandatin e saj ligjorë ka bërë kërkesë për informacione shtesë edhe në Ministrinë e Mbrotjtjes ku ka kërkuar informacione shtesë në lidhje me pretendimet tjera të ngritura, dhe sipas informacioneve të vlerësuara, nuk ka rezultuar të ketë ndonjë element të Konfliktit të Interesit, në ndërkohë Agjencia, ka pranuar informacione edhe nga znj. Artina Hamitaga, ku jemi njoftuar se janë bërë ndryshimet e nevojshme në bizneset me emër “Ulpiana Consulting L.L.C”. dhe A Tech Solution SH.P.K”, ku dhe dëshmohen edhe përmes informatës zyrtare nga ARBK-ja, se e njëjta nuk figuron më të jetë përfaqësues i autorizuar në këto biznese .

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtarja e lartë, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, ndërsa sa i përket pretendimeve tjera të ngritura nga raportuesi i rastit nuk është arritur të vërtetohet situata e konfliktit të interesit.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:


Ylli Buleshkaj
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)